

## STATUTI

### I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

#### “ ERDHA ” sh.p.k

Sot, me datë 4/02/2022 (dymijë e njëzet e dy), ne të nënshkruarit:

1. **Znj. Dorina NDOJ**, e bija e Preng, e datëlindjes 27.02.1983, lindur në Laç, Shqipëri dhe banues në Tiranë, madhore dhe e afte per te kryer veprime juridike, mbajtëse e letërnjoftimit no. 035669085, leshuar me date 27.01.2020.
2. **Z. Mirgen ZAÇELLARI**, i biri i Gurali, i datëlindjes 15.09.1982, lindur në Përg, Shqipëri dhe banues në Tiranë, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike, mbajtës i letërnjoftimit no. 037174796, leshuar me date 16.04.2021.
3. **Z. Andi DOLLAPI**, i biri i Sahit, i datëlindjes 22.09.1993, lindur në Korçë, Shqipëri dhe banues në Tiranë, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike, mbajtës i pasaportës no. BE2942914, leshuar me date 25.08.2020.
4. **Z. Kristo XHIMO**, i biri i Panajot, i datëlindjes 13.02.1995, lindur në Selanik, Greqi dhe banues në Elbasan, madhor dhe i afte per te kryer veprime juridike, mbajtës i pasaportës no. BE0702411, leshuar me date 15.03.2012.

me qëllim themelimin dhe regjistrimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit miratojmë Statutin e “ERDHA” sh.p.k, në përputhje me legjislacionin shqiptar, vullnetin tonë të shprehur në aktin e themelimit dhe dispozitat si më poshtë.

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i shoqërisë;

## KREU I

### EMËRTIMI I SHOQERISE – SELIA – OBJEKTI - KOHËZGJATJA

#### Neni 1

#### Emërtimi i Shoqërisë

- 1.1. Shoqëria është krijuar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është **ERDHA sh.p.k.** (“Shoqëria”).
- 1.2. Shoqëria ushtron aktivitetin e saj në përputhje me ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”; i ndryshuar (“Ligji Tregtar”), legjislacionin shqiptar në fuqi me këtë Statut.

## **Neni 2** **Selia e Shoqerisë**

- 2.1. Selia e Shoqerisë ndodhet në adresën Rr. e Barrikadave, Qendra Galeria e Tiranës, Pallati Ndërtim Vila & Co, Hyrja 9/1, Kati nr.8, Ap.23, Tirana.
- 2.2. Shoqëria mund të krijojë degë, seli dytësore dhe të zhvillojë aktivitet në vende të tjera, brënda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë me vendim të Administratorit/ve.

## **Neni 3:** **Objekti i Shoqerisë**

- 3.1. Shoqëria “ERDHA” sh.p.k, ka si objekt të veprimtarisë tregtare të saj, por pa u kufizuar:

*Ofrimin e shërbimëve teknike e inxhinierike në fushën Civile e Industriale që përfshin projektimin, furnizimin, realizimin, menaxhimin riparimin e mirëmbajtjen. Krahas, shoqëria angazhohet dhe në çdo lloj operacioni financiar apo tregtar, që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, akt-marrëveshje me palë të treta brënda limiteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi. Shoqëria me qëllim të arritjes së objektivave të saj mund të marrë përsipër direkt apo indirekt, pjesëmarrje në fitime e pjesëmarrje në shoqëri të tjera shqiptare ose të huaj, që kanë objekt të njejtë apo të ngjashëm me objektin e saj.*

## **Neni 4** **Kohëzgjatja**

- 4.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje të pacaktuar duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.

## **KREU II** **KAPITALI**

### **Neni 5** **Kapitali themeltar**

- 5.1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë “ERDHA” sh.p.k është 200.000,00 (dyqind mijë) Lekë, i ndarë në 4 (katër) kuota me vlerë 50.000,00 (pesëqind mijë) secila.
- 5.2. Në rast zmadhimi të kapitalit, ortakëve iu rezervohet e drejta e përparësisë për nënshkrimin e kuotave të reja në raport me kuotat e zotëruara në kapitalin e Shoqerisë, përveçse kur me marrëveshje ortakët vendosin ndryshe.

## **Neni 6 Ortakët**

6.1. Ortakët e Shoqerisë janë, si vijon:

1. Znj. Dorina NDOJ, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë të barazvlefshme me 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqerisë.
2. Z. Mirgen ZAÇELLARI, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë të barazvlefshme me 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqerisë.
3. Z. Andi DOLLAPI, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë të barazvlefshme me 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqerisë.
4. Z. Kristo XHIMO, zotërues i 1 (një) kuote me vlerë 50.000,00 (pesëdhjetë mijë) Lekë të barazvlefshme me 25% (njëzet e pesë përqind) të kapitalit të Shoqerisë.

## **Neni 7 Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## **Neni 8 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### **KREU III ASAMBLEJA E ORTAKËVE**

#### **Neni 9 Organi Vendimmarres**

- 9.1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.
- 9.2. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.
- 9.3. Asambleja e pergjithshme e ortakeve eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per cheshtjet e meposhtme:
- a) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emelimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emelimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te ekspertëve kontabël te autorizuar;
  - d) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat “c” dhe “ç” te kesaj pike;
  - dh) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratorët, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
  - ë) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
  - f) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) perfaqesimin e shoqerise ne gjykatë dhe ne procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
  - h) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblesë;
  - i) cheshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
- 9.4. Ortaku mund te perfaqesohet ne asambленë e pergjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjetër apo nga nje person i tretë.
- 9.5. Administratori i shoqerise nuk mund te veproj si perfaqesues i ortakeve ne asambленë e pergjithshme.
- 9.6. Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblesë se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njetin rend dite.

#### **Neni 10 Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme**

- 10.1. Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkresë ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet te permbaje vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dergohet te gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë perpara datës së parashikuar per mbledhjen e asamblesë.

10.2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

### **Neni 11 Kuorumi**

11.1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

11.2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare “, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkrësë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **Neni 12 Marrja e vendimeve**

12.1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

12.2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
  - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - ç) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**Neni 13**  
**Përfashtimi nga e drejta e votës**

13.1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

13.2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

**KREU IV**  
**ADMINISTRIMI I SHOQERISË**

**Neni 14**  
**Administrimi**

14.1. Administrimi i Shoqerisë do të kryhet nga 1 (një) Administrator.

14.2. Administratori do të emërohet nga asambleja e ortakëve dhe mund të shkarkohet në çdo kohë me vendim të asamblesë së ortakëve.

14.3. Administratori do të jetë person fizik pa asnjë kufizim për sa i përket kombësisë së tij. Afati i emërimit i Administratorit do të caktohet në momentin e emërimit të tij por ky afat nuk mund të jetë më i gjatë se 5 (pesë) vjet. Pa cënuar këtë kufizim, afati i emërimit të tyre mund të ripërtërihet me vendim të asamblesë së ortakëve.

14.4. Administratori do të rimbursohet për shpenzimet e kryera gjatë ushtrimit të detyrave të tij. Asambleja e ortakëve mund të vendosë të japë dhe shpërblime vjetore.

14.5. Në rast dorëheqje Administratori do të njoftojë me shkrim asamblenë e ortakëve. Administratori, që të japë dorëheqjen, duke pasur parasysh rrethanat e veprimtarisë së Shoqerisë do të thërrasë asamblenë e përgjithshme për emërimin e administratorit të ri, përpara datës në të cilën dorëheqja të hyjë në fuqi.

**Neni 15**  
**Kompetencat e Administratorëve**

15.1 Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

15.2. Administratoret janë të detyruar të thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

-sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

-shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

-shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

15.3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

15.4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

15.5. Administratori I parë I Shoqërisë I emëruar për një afat 5 (pesë) vjeçar nga data e regjistrimit të Shoqërisë në Regjistrin Tregtar do të jetë:

1. **Z. Kristo XHIMO**, i biri i Panajot, i datëlindjes 13.02.1995, lindur në Selanik, Greqi dhe banues në Elbasan, madhor dhe i afte për të kryer veprime juridike, mbajtës i pasaportës no. BE0702411, leshuar me datë 15.03.2012.

## Neni 16

### Përgjegjësitë e Administratorit

16.1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

16.2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

16.3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

16.4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

16.5. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t’i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

16.6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t’i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

**KREU V**  
**VITI USHTRIMOR - KONTROLI KONTABËL – PRISHJA DHE LIKUJDIMI**

**Neni 17**  
**Viti Financiar**

17.1. Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

17.2. Në përfundim të çdo viti financiar, Administratori harton pasqyrat financiare në përputhje me ligjin.

**Neni 18**  
**Ekspertet**

18.1. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollat periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollat periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t’ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

**Neni 19**  
**Prishja dhe likuidimi**

19.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

19.2. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

19.3. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

19.4. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 20**  
**Riorganizimi i Shoqerisë. Bashkimi - Ndarja**

20.1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

**Neni 21**  
**Baza Ligjore**

21.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.


21.2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 22**  
**Mosmarrëveshjet**


22.1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.


Ky Statut i Shoqërisë u hartua në pesë (5) origjinale në gjuhën shqipe.

**ORTAKET**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ERDHA” sh.p.k**

  
Dorina NDOJ

  
Mirgen ZAÇELLARI

  
Andi DOLLAPI

  
Kristo XHIMO